



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË
LIGJIT NR.138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 14.01.2020, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për këshillat bashkiak, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a" i Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 11, i ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 01 i vendimit Data 14.01.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VËREN

Disa këshilla bashkiak kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për arsye të dorëheqjeve ose humbjes së mandatit të disa këshilltarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidatët për këshilltarë përcaktuar në bazë të listave shumëmemërore të subjekteve përkatëse, kanë plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të 20 (njëzet) kandidatëve për anëtarë në këshillat bashkiak, rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Znj. Adelina Ago Kaloti, me dt. 13.05.2019 në momentin e kandidimit ka dorëzuar formularin e vetdeklarimit. Në pyetjen 7 të formularit të vetëdeklarimit është përgjigjur "PO" pyetjes "A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj? Kandidatja ka deklaruar se është dëbuar për arsye të tejkalimit të afateve të qëndrimit në 29.11.2018 nga Gjermania. Gjithashtu kandidatja është përgjigjur me "PO", pyetjes 8 të formularit të vetëdeklarimit "A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?" e cila ka deklaruar se ka qëndruar në Gissen Gjermani për arsye shëndetësore nga 08.09.2016 deri 29.11.2018.

Me dt. 27.11.2019 ka dorëzuar formularin e vetdeklarimit nr. Unik 13731, ku rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr.138/2015 dhe është përgjigjur me "JO" pyetjeve nr. 7 dhe nr.8.

Referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit, KQZ konstaton se për kandidaten znj. Adelina Ago Kaloti, kjo e dhënë nuk përbën kusht për moszgjedhshmërinë si anëtare për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr.138/2015.

Me plotësimin e njërës vakancë në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste, Bashkia Kavajë, rezulton se lista e kandidatëve të Partisë Socialiste, në Bashkinë Kavajë, ka shteruar.

Sipas nenit 164, pika 4 të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare e një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë. Në zgjedhjet lokale të datës 30.06.2019, Partia Socialiste ka qenë pjesëtare e Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, regjistruar në KQZ, me vendimin nr. 251, datë 07.05.2019 "Për regjistrimin e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30.06.2019".



Nr . 01 i vendimit Data 14.01.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr. 32, datë 23.07.2019, "Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Kavajë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore 2019", Koalicioni Aleanca për Shqipërinë Europiane ka fituar 31 mandate.

Partia Socialiste ka fituar 29 mandate, Partia Socialiste e Moderuar ka fituar 1 mandat dhe Partia G-99 ka fituar 1 mandat. Sipas nenit 163/2 të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme të secilës parti të Koalicionit, pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse për koalicionin në fjalë.

Herësit e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen, sipas tabelës më lartë, nga ku rezulton se brenda koalicionit, partia me herësin më të madhe (77 dhe 46) është Partia Socialiste e Moderuar dhe (62) Partia G99. Në këto kushte mandati i ndërprerë i dhe mandati i ndërprerë i z. Erion Shpëtim Lalaj me numër rendor 29, i kalon Partisë Socialiste e Moderuar, ndërsa mandati i ndërprerë i z. Aldo Ilirjan Duro me numër rendor 23, i kalon Partisë G-99 dhe mandati i ndërprerë i znj. Valbona Sezai Mustafa me numër rendor 2, i kalon Partisë Socialiste e Moderuar.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste në Bashkinë Kavajë nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës së znj. Valbona Sezai Mustafa do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë të këshillit bashkiak Kavajë, të Partisë Socialiste e Moderuar, rezulton se pas numrit rendor 2, znj. Lavdie Ardian Gjini e ftuar për zëvendësimin e vakancës së z. Erion Shpëtim Lalaj, dhe pas numrit rendor 3, z. Leonard Ardian Gjini kandidati i rradhës është kandidati me numër rendor 4; (katër) zj. Idajete Beqir Doka.

Referuar nenit 11 të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit u takon të marrin mandatin e anëtarit për vendin vakant, sipas Kodit Zgjedhor.

Znj. Lavdie Ardian Gjini dhe znj. Idajete Beqir Doka, kanë depozituar formularin e vetëdeklarimit në KQZ si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publike, kandidatë të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste e Moderuar, Këshilli i Bashkisë Kavajë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", me shkresat nr.14896 prot., datë 05.12.2019, nr.14994 prot., datë 16.12.2019, nr.15028 prot., datë 18.12.2019 dhe nr.03 prot., 06.01.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresat nr.14897 prot., datë 05.12.2019, nr.14993 prot., datë 16.12.2019, nr.15029 prot., datë 18.12.2019 dhe nr.02 prot., datë 06.01.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.



Nr . 01 i vendimit Data 14.01.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Në përgjigje të shkresave nr.14897/1 prot., datë 12.12.2019, nr.14993/1 prot., datë 20.12.2019, nr.15029/1 prot., datë 18.12.2019 dhe nr.02/1 prot., datë 10.01.2020 zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për 20 (njëzet) kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Referuar nenit 8, pika 1 të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kreu V, pika 2, germa "c" dhe kreu V, pika 3, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, organi kompetent është Prokuroria e Përgjithshme.

Referuar nenit 49 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se për 20 (njëzet) kandidatët për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilëve nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatëve në funksionin e këshilltarit, duhet vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshillat bashkiak përkatës dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e Ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e këshillave bashkiak për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit kandidatëve të listave shumëmemërore, për plotësimin e vendeve vakant në këshillat bashkiak, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 01 i vendimit Data 14.01.2020 e vendimit Ora 11:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak ,në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".